

RAPORT VJETOR 2021



i madh dhe i sigurt



www.insig.com.al

Shqipëri
Rruga “Jul Variboba” Nr. 21 , Tiranë, Shqipëri
Tel: +355 42 400 792 ,
Fax: +35542400800 ,
E-mail: info@insig.com.al

RAPORT VJETOR

2021

Përmbajtja

Fjala e Drejtorit të Përgjithshëm.....	5
Ecuria e tregut të sigurimeve në Shqipëri, viti 2021.....	6
Pronësia mbi kompaninë.....	7
Organizimi i kompanisë.....	8
Organigrama 2021.....	9
Aktiviteti sigurues.....	10
Dëme të paguara.....	11
Përgjegjësia sociale, promovimi i vlerave të Insig.....	12
Monitorimi, administrimi dhe kontrolli i riskut që ndërmerr Insig.....	18
Njësia e auditit të brendshëm të vitit 2021	22
Auditimi i Jashtëm.....	25
Treguesit e mjaftueshmërisë së kapitalit, treguesit e likuiditetit dhe treguesit e Aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike.....	32

Të nderuar aksionarë,

Të nderuar klientë, partnerë, miq dhe bashkëpunëtorë të Insig sh.a,

Viti 2021 ishte vitit i dytë në të cilin bota vazhdoi të përballët me pandeminë COVID-19, e cila si kudo në botë, edhe në vendin tonë pati pasoja të konsiderueshme.

Ndonëse në përballje me një situatë kaq të vështirë, e cila preku jetën e gjithsecilit prej nesh, dhe sidomos ndikoi ekonominë e vendit, Insig sh.a i orientuar përmes një vizioni largpamës të Aksionarit dhe Këshillit Mbykëqyrës, planit strategjik dhe drejtimit institucional, arriti të menaxhojë në mënyrë efektive dhe eficiente të gjitha sfidat e kësaj periudhe.

Insig sh.a duke patur një menaxhim të shkëlqyer në të gjitha nivelet drejtuese, i orientuar drejt tregut dhe me një staf të kualifikuar ka arritur të krijojë standartet më të larta të shërbimit ndaj klientit, duke manifestuar prosperitet dhe qëndrueshmëri në tregun e sigurimeve në Shqipëri.

Edhe pse në një mjedis me faktorë jo favorizues për periudhën, Insig sh.a gjatë vitit 2021 ka patur një ecure shumë të mirë në realizimin e objektivave dhe konsolidimin e prezencës në tregun e sigurimeve, si edhe sa i takon nivelit të kapitalit në funksion të rritjes së aftësisë paguese.


Gjatë vitit 2021, Insig sh.a realizoi 1,233,284,638 lekë prime të shkruara bruto, dëmet e paguara bruto ishin në vlerën 313,389,704 lekë, si edhe pagesa e dëmeve të Fondit të Kompensimit ishte 32,158,335 lekë, ose 12% e shumës së këtij fondi të paguar nga gjithë tregu i sigurimeve.

Niveli i produkteve të sigurimeve vullnetare kundrejt atyre të detyrueshme, gjatë vitit 2021, shënoi vlerën 19.73% ndaj totalit të portofolit, shifër kjo e cila do të vazhdojë të jetë një ndër prioritetet më të rëndësishme për të ardhmen.

Treguesit e mësipërm për vitin 2021, si edhe trendi pozitiv gjatë gjysmës së parë të vitit 2022, janë rezultat i përkushtimit dhe profesionalizmit të stafit të shoqërisë sonë, vizionit dhe përkujdesjes së vazhdueshme të Aksionarit dhe Këshillit Mbikëqyrës, të cilët i falënderoj përzemërsisht për mbështetjen.

Gjithashtu, dëshiroj të falënderoj përzemërsisht të gjithë klientët dhe partnerët tanë për besimin e vazhdueshëm dhe marrëdhëniet e shkëlqyera me Insig sh.a.

Në emër të kompanisë dëshiroj të shpreh falënderimin dhe mirënjohjen për të gjithë punonjësit e Insig sh.a, puna dhe përpjekjet e të cilëve kanë bërë të mundur këtë performancë të lartë të shoqërisë, duke garantuar konsolidim dhe qëndrueshmëri në të ardhmen.



Ju faleminderit!
Forcim Kola
Drejtor i Përgjithshëm

Ecuria e tregut të sigurimeve në Shqipëri, viti 2021

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për vitin 2021 kapën vlerën 19,268 milionë lekë, ose 16.02% më shumë se në vitin 2020. Gjatë vitit 2021, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 1,173,520 me një rritje prej 22.7% krahasuar me një vit më parë. Tregu mbetet i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 92.44% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, ndërsa sigurimet e Jetës kanë 7.42%. Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 38.35% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 61.65% të totalit të tregut. Gjatë vitit 2021, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 6,666 milionë lekë, ose 11.08% më pak se në vitin 2020, ndikuar kryesisht nga pagesa e pjesës më të madhe të dëmshpërblimeve për tërmetet e fund vitit 2019. Ndërkohë dëmet e paguara bruto në sigurimin motorik për vitin 2021 kapën vlerën 3,986 milionë lekë, duke pësuar një rritje me rreth 20.25% krahasuar me vitin 2020.



PRONËSIA MBI KOMPANINË

Në përputhje me Statutin e kompanisë, Neni 6, kapitali themeltar ,pas ndarjes se aktivitetit ne 01.01.2017 ne INSIG Jete dhe INSIG sh.a., është 650,000,000 lekë (gjashtëqind e pesedhjetë milion), i ndarë në 1,083 (njëmijë e tetëdhjetë e tre) aksione, me vlerë nominale 600.184,672 lekë secili. Gjatë vitit 2016, aksionet e shoqërisë iu shiten në masën 100% shoqerise se sigurimeve Eurosig sh.a.

Këshilli Mbikqyrës:

Vasil Pilo - **Kryetar**

Anila Ibraj - **Anëtare**

Thanas Xhillari - **Anëtar**



Organizimi i Kompanisë:

Rrjeti i Shpërndarjes së INSIG sh.a.

Degët dhe numri i punonjësve

Shqipëri

2021 Nr. Mesatar i punonjësve të INSIG sh.a. QENDER - 43


Gjendja 31.12.2021		
Nr.rendor	Degët / Agjencite	Nr. i punonjësve
1	BERAT	5
2	DIBER	4
3	DURRES	4
4	ELBASAN	3
5	FIER	3
6	GJIROKASTER	4
7	KAVAJE	3
8	KORCE	7
9	KUKES	1
10	LAÇ	1
11	LEZHE	3
12	LUSHNJE	3
13	POGRADEC	9
14	SARANDE	3
15	SHKODER	7
16	TIRANE 1	9
16 a	TIRANE 2	6
16 b	TIRANE 3	13
17	VLORE	5
18	Kamez	1

Organigrama 2021

ORGANIGRAMA E SHOQËRISË "INSIG" SH.A.

MIRATOHET
KRYETARI I KËSHILLIT MBIKËQYRËS

VASIL PILO



DREJTORI I PËRGJITHSHËM


Gëzim TOLA

AKTIVITETI SIGURUES

Në vitin 2021, u shkruan 1,233,284 mijë lekë prime nga sigurimi i Jo Jetës për INSIG sha në territorin e Shqipërisë. Rreth 85% e primeve të shkruara bruto erdhi nga sigurimet motorrike, 13% nga sigurimet e pronës dhe 2% nga aksidentet dhe shëndeti.

Shpërndarja e primeve bruto sipas linjave të biznesit, për INSIG sha Shqipëri

Lloji i produktit	Viti 2021	Viti 2020
Motorrike	85%	84%
Pasuri	13%	14%
Shëndet	2%	2%
Totali	100%	100%



DËME TË PAGUARA

Përgjatë vitit 2021, INSIG sh.a. u fokusua në përmirësimin e ndjeshëm të shërbimit ndaj klientit nëpërmjet procedurave më fleksibile dhe të shpejtë. Gjatë vitit 2021 vlera e dëmeve të paguara kapin shifrën prej 313,390 mijë lekë.

Dëme të Paguara në mijë lekë	
2021	313,390
2020	273,796



PËRGJEGJËSIA SOCIALE, PROMOVIMI I VLERAVE TË INSIG



Përgjegjësia sociale është një vlerë e shtuar e Grupit Financiar Eurosig–Insig-UBA. Falë angazhimit dhe kujdesit të vazhdueshëm të Presidentit, Z. Kadri Morinaj, subjektet e Grupit janë të angazhuara për të maksimizuar ndikimin pozitiv në shoqëri dhe mjedisin ku ushtrojnë veprimtarinë. Një vëmendje të veçantë Grupi dhe Presidenti Morinaj kanë ndaj mjedisit kulturor, artistik, mediatik, si dhe ndaj shtresave në nevojë.

Ndër veprimtaritë e mbështetura në vitin 2021 nga Grupi Financiar Eurosig-Insig-UBA dhe Presidenti i Grupit, Zoti Kadri Morinaj, veçojmë:

- Janar 2021 - Krijimi i një atmosfere magjike dhe shpërndarja e dhuratave për ata që kanë më shumë nevojë, për engjëjt e vegjël të Qendrës Shqiptare për Integrimin e Njerëzve me Nevoja të Veçanta.
- Janar 2021 - Mbështetje e webinarit të organizuar nga Qendra Shqiptare për Qeverisjen e Mirë, në bashkëpunim me Fondacionin “Konrad Adenauer Albania”, ku morën pjesë me prezantimin e punimeve të tyre qindra studentë të përkushtuar, duke mundur edhe çmimet për 3 fituesit e eseve më të arrira.
- Mars 2021 - Mbështetje për hapjen e Qendrës Multifunkionale për të rinjtë në qytetin e Krumës. Në këtë oaz dijeje dhe kulture, të rinjtë hasjanë do të kenë mundësinë të kalojnë kohën e lirë duke lexuar libra, duke bërë projekte, konkurse, lojëra, diskutime dhe duke marrë njohuri të ndryshme socialo-

shkencore. Të privilegjuar për investimin, urojmë që qendra të tilla të jenë sa më të shumta në funksion të zhvillimit kulturor në të gjithë Shqipërinë.

- Mars 2021 - Dhurimi i 10 mijë dollarëve për familjen e "Dëshmorit të Atdheut", Arjan Salës, për aktin heroik të shpëtimit të 22 kolegëve të tij nga zjarri që ra tek Casa Italia. Djalit të Arjan Salës ju vendos dhe një page mujore, deri në përfundim të studimeve të larta, si kontribut për rritjen dhe mirëedukimin e tij.
- Maj 2021 - Grupi Financiar Eurosig-Insig-UBA ka dhënë një mbështetje të vazhdueshme për mirëfunksionimin e Shoqatës Kombëtare të Miqësisë Shqipëri-Itali, e cila, në maj 2021, festoi në qytetin e Laçit 30-vjetorin e krijimit të saj.
- Maj 2021 - Falë mbështetjes dhe ndihmës në vite, në ceremoninë e 10-vjetorit të krijimit, Shoqata e Shkrimtarëve, Artistëve dhe Krijuesve Shqiptarë në Suedi "Papa Klementi XI-Albani" shpalli Presidentin e Grupit Eurosig-Insig-UBA, Z. Kadri Morinaj, Anëtar Nderi, me motivacionin: Biznesmen i suksesshëm në ndihmë për shkollat shqipe, kultet fetare, revistën "Miqësia" dhe njerëzit në nevojë, me vite të tëra.
- Qershor 2021 - Dhënia 300 000 lekë ndihmë për nënën e djaloshtit të pafajshëm, Musaen Zeneli, vrarë aksidentalisht në Velipojë, i cili do mbetet në memorien tonë si një djalë punëtor që në moshë të vogël, për veten dhe nënën e tij.
- Korrik 2021 - Mbështetje për @hemingwaytirana për organizimin e Hemingway Jazz Fest No.8, më 20 dhe 21 korrik. Dy netë të paharrueshme Jazz me @rumbadebodas, Devon&Jah Brothers, Roy Paci&Aretuska dhe Lehmanns Brothers.



- Gusht 2021 - Mbështetje për koncertin “Të gjitha rrugët të çojnë në Tiranë”, organizuar në Amfiteatrin e Ligenit, duke mbledhur bashkë një grup artistësh dhe këngëtarësh shqiptarë, si dëshmia më e mirë se jeta po rikthehet në normalitet.
- Gusht 2021 - Mbështetje për të dytin vit radhazi e kompozitorit të njohur Gjergj Leka në organizimin e Festës së Këngës Shqiptare. Këngëtarë të rinj të talentuar, gjatë tre netëve të aktivitetit, sollën perlat e muzikës shqiptare ndër vite. Stafi i Grupit Eurosig-Insig-UBA mbështeti financiarisht produksionin e këngës së një vajzë shumë të talentuar dhe me zë të fuqishëm, znj. Leandra Godaj, duke i uruar të shkëlqejë në të ardhmen në muzikën shqiptare, pse jo edhe atë botërore.
- Shtator 2021 - Mbështetje për organizimin e spektaklit në Sheshin “Skënderbej” për dy herë kampionin e Evropës, Z. Ervis Bici, i cili konkuroi për titull Europe në Muay Thai. Në aktivitetin e ndërthurur mes muzikës, sportit Muay Thai dhe bamirësisë, publiku u argëtua nga artistët Noizi, Dafina Zeqiri dhe Besart Kallaku.
- Tetor 2021 - Me rastin e dhënies së 3 çmimeve të para në Maratonën e Tiranës për personat me aftësi të kufizuar, Presidenti i Grupit, Zoti Kadri Morinaj, theksoi: “Mbështetja për këtë kategori nuk është vetëm morale, por edhe financiare, pasi pjesëmarrja e tyre në këtë maratonë është një insipirim



për të gjithë ne. Personat me aftësi të kufizuara na shtynë të shohim jetën ndryshe dhe plot ngjyra. Kjo kategori është maratona e vërtetë!”

- Tetor 2021 - Bashkimi me rrjetit ASAN, në mbështetje të nismës “Dita e Solidaritetit dhe Aktivizmit Social në Shqipëri!”, si pjesë e nismës që zhvillohet në të gjithë Europën. 45 të rinj u bënë pjesë e Grupit Financiar Eurosig-Insig-UBA dhe Restorant Piazza, duke qëndruar pranë ekspertëve tanë dhe duke marrë eksperiencë të ndryshme lidhur me këto kompani, ku u trajnuan mbi shërbimet dhe produktet e industrisë së sigurimeve dhe asaj bankare. Në pritjen e organizuar për këta të rinj, Presidenti i Grupit, Z. Kadri Morinaj, u shpjegoi atyre rrugëtimin në biznes dhe u dha shumë këshilla për leadershipin dhe biznesin. Zoti Morinaj u dha atyre edhe një mbështetje financiare për kohën që kaluan si pjesë e stafeve të Grupit.
- Nëntor 2021-Mbështetje për organizimin e edicionit të 11-të të “Albanian Coast Trip”, ku u bashkuan jo vetëm parashutistët shqiptarë nga të gjitha trevat shqiptare, por u mundësua ardhja e parashutistëve nga e gjithë bota për të ngritur trofe në Shqipëri.
- Nëntor 2021 - Mbështetje për realizimin e filmit më të ri të aktorit Drilon Hoxha, “Shkëmbimi”. Klark Morinaj është një nga protagonistët e këtij filmi aksion, komedi, dramë, romancë, që ka bërë bashkë edhe aktorë të mëdhenj si Bujar Asqeriu, Sejfulla Myftari, Natasha Sela dhe Çun Lajçi. Për realizimin e



filmit, regjisori dhe aktorët janë impenjuar maksimalisht, duke xhiruar edhe jashtë vendit, deri në SHBA.

- Nëntor 2021 - Mbështetje e Simpoziumit Shkencor me temë: “Gjeoshkencat, Arritjet dhe Sfidat e të Ardhmes”, me rastin e 70-vjetorit të Universitetit Politeknik të Tiranës, Me këtë rast u shpërndanë Certifikata Nderi për ajkën e profesorëve që kontribuojnë dhe studiojnë Gjeoshkencat e vendit tonë.
- Dhjetor 2021 – Grupi Financiar Eurosig-Insig-UBA është mbështetësi kryesor në vite i Festivalit të RTSH, duke kontribuar që kompeticioni më i rëndësishëm muzikor i vitit të ngrihet gjithnjë e më lart dhe të kemi përfaqësim sa më dinjitoz edhe në skenën europiane të këngës “Eurovision”.
- Dhjetor 2021 - Çdo fundviti, së bashku me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, ne ju gjendemi pranë fëmijëve të punonjësve të policisë të rënë në detyrë. Në aktivitete të ndryshme të organizuara për ta, duke u shpërndarë dhe dhurata të shumta, shprehim mirënjohje të pafund për baballarët e tyre, që dhanë jetën për garantimin e sigurisë publike në vendin tonë.





Veprimtari të tjera promovuese:

- Janar 2021 - Maqedonia e Veriut vazhdon të jetë në fokusin e Grupit Financiar Eurosig-Insig-UBA, për të investuar dhe kontribuar në zhvillimin e këtij vendi. Në takimet me kryetarin e Kuvendit të Maqedonisë së Veriut, Z. Talat Xhaferri, ku ishte i pranishëm edhe ambasadori i Republikës së Shqipërisë, Z. Fatos Reka, dhe me kryeministrin e Maqedonisë së Veriut, Z. Zoran Zaev, presidenti i Grupit, Z. Kadri Morinaj, u përqendrua në investimet e ardhshme të Grupit në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në fushën e industrisë financiare. Kryeministri Zaev falënderoi Z. Morinaj për investimet e kryera prej miliona eurosh në Maqedoninë e Veriut dhe garantoj mbështetjen e tij maksimale për Grupin Eurosig-Insig-UBA në investimet e ardhshme në industrinë financiare.
- Korrik 2021 - Presidenti i Grupit Financiar Eurosig-Insig-UBA, Z. Kadri Morinaj, mori pjesë në "Forumin Ekonomik për Bashkëpunimin Rajonal", që u mbajt në Shkup me pjesëmarrjen e kryeministrit të Shqipërisë Z. Edi Rama, kryeministrit të Maqedonisë së Veriut Z. Zoran Zaev, dhe presidentit të Serbisë Z. Aleksandar Vuçiç. Presidenti Morinaj zhvilloi disa takime me përfaqësues të biznesit maqedonas, serb dhe shqiptar.
- Gusht 2021 - Presidenti i Grupit Financiar Eurosig-Insig-UBA, Z. Kadri Morinaj, së bashku me Kryegjyshin Baba Mondin uruan shqiptarët gjatë

pelegrinazhit në Malin e Tomorrit, duke u lutur "për paqe, dashuri e harmoni mes njerëzve". Në mesazhin e përcjellë për besimtarët shqiptarë, Z. Morinaj theksoi se "Baba Aliu dhe Mali i Tomorrit kanë qenë një dhe kanë ngjallur shpresë tek shqiptarët. Klerikët bektashinj kanë qenë njerëz të dijes dhe me vlera në shoqërinë tonë. Ata kanë promovuar vlerat kombëtare, paqen dhe mirësinë e tyre kudo."

- Tetor 2021 - Grupi Financiar Eurosig-Insig-UBA ndezi dritat rozë, në shenjë solidarizimi për Ndërgjegjësimin e Kancerit të Gjirit. Me mesazhin se "çdo grua është nëna apo motra jonë dhe ne duhet të jemi gjithnjë pranë tyre", u synua dhe sensibilizimi i opinionit për t'i nxitur ato të kryejnë kontrollet mjekësore për kancerin e gjirit, sepse vetëm kështu mund të jemi të sigurtë për shëndetin dhe jetët e tyre.
- Nëntor 2021 - Grupi Financiar Eurosig-Insig-UBA ju bashkua fushatës së sensibilizimit për aksidentet rrugore në Ditën Ndërkombëtare të Viktimave të Trafikut Rrugor. Çdo vit, në mbarë globin, si pasojë e aksidenteve në trafikun rrugor vdesin 1.25 milionë njerëz dhe dhjetëra miliona të tjerë mbesin të lënduar rëndë. Aksidentet në trafikun rrugor janë shkaktari numër një i vdekjeve të rinjve të moshës 15-29 vjeç dhe shkaktari i tetë i vdekjeve në mesin e të gjithë njerëzve në mbarë botën.
- Dhjetor 2021 - Grupi Financiar Eurosig-Insig-UBA ishte pjesë e Panairit Ndërkombëtar të Tiranës "Porta drejt Ballkanit". Ekspozues të ardhur nga mbi 25 shtete të botës diktuan në shqip fjalët e fundit të teknologjive dhe mund të jenë bashkëpunëtorët e ardhshëm të tregut të Shqipërisë dhe të zonës që ajo përfaqëson gjeografikisht nën emërtimin "Porta drejt Ballkanit".
- Dhjetor 2021 - Entuziazmin për festën e Vitit të Ri 2022, Grupi Financiar Eurosig-Insig-UBA e bashkoi me udhëtim drejt Shishtavecit të Kukësit për të vizituar dhe promovuar këtë zonë me male, pllaja e liqene të mrekullueshme. Në këtë aktivitet, Presidenti i Grupit, Z. Kadri Morinaj, pasi u uroj mbarësi dhe begati gjithë stafit të Grupit, u bëri thirrje biznesmenëve për të ndërtuar pistat e skive më të mëdha në Ballkan në zonën e Shishtavecit të Kukësit, pasi mundësitë dhe resurset që ofron kjo zonë janë të pafund.
- Dhjetor 2021 - Ndryshe nga çdo vit tjetër, festave të fundvitit të Grupit Financiar Eurosig-Insig-UBA ju bashkuan fëmijët e mrekullueshëm të stafit; e thënë ndryshe nga Presidenti Morinaj "e ardhmja e vendit tonë". Në këtë festë spektakolare për punonjësit, Presidenti i Grupit, Z. Kadri Morinaj, u bëri atyre shumë surpriza, si: balerinët më të mirë në vend, Enada&Gerdi, këngëtarët Anxhela Peristeri dhe Gena, që ndezën maksimalisht atmosferën. Por ajo që lumturoi më shumë ishin fëmijët e stafit, për të cilët u organizua një festë shumë e bukur, duke i argëtuar pa masë dhe duke u shpërndarë dhurata të shumta.

Monitorimi, administrimi dhe kontrolli i riskut që ndërmerr INSIG

Në INSIG është implementuar një sistem i plotë i menaxhimit të riskut i shpërndarë në të gjitha nivelet, për të identifikuar, vlerësuar, mbikëqyrur, menaxhuar dhe raportuar në vijimësi risqet me të cilat është përballur ose mund të përballlet Shoqëria, në mënyrë që të mbështesin realizimin e objektivave strategjike dhe specifike. Strukturat e INSIG zbatojnë elementët e këtij sistemi, duke u bazuar në kuadrin ligjor e rregullator në fuqi, si dhe në natyrën, shkallën dhe kompleksitetin e veprimtarisë së Shoqërisë.

Për rregullimin dhe normimin e punës së strukturave të INSIG, në tërësi, si dhe në drejtim të pranimi dhe menaxhimit të riskut, organet qeverisëse kanë nxjerrë një paketë aktesh të brendshme, në përputhje me përcaktimet ligjore dhe rregullatore. Organet drejtuese, menaxhmenti dhe çdo punonjës ka të përcaktuar qartë përgjegjësitë dhe kufizimet e autoritetit të tij në aktet e brendshme të INSIG, në lidhje me riskun dhe menaxhimin e tij. Kjo siguron dhe lidhjen e nevojshme midis detyrave që kanë dhe mënyrës se si i kryejnë ato.

Sistemi i menaxhimit të riskut në INSIG bazohet në mirëfunksionimin e tri linjave të mbrojtjes: Funksionet Operacionale, që përfaqësojnë linjën e parë të mbrojtjes dhe kanë përgjegjësinë kryesore për menaxhimin e risqeve që lidhen me fushat e përgjegjësi të tyre; Funksioni i Menaxhimit të Riskut, Aktuari i Autorizuar dhe Funksioni i Pajtuashmërisë, që përfaqësojnë linjën e dytë të mbrojtjes; Auditimi i Brendshëm, që përfaqëson linjën e tretë të mbrojtjes.

Qasja më e mirë për menaxhimin e riskut, të cilën e aplikon dhe INSIG, është pasja e një dokumenti strategjik për Menaxhimin e Riskut në të gjitha nivelet e Shoqërisë. Në këtë Strategji janë përcaktuar sistemi, politika dhe parimet e menaxhimit të riskut; procesi i menaxhimit të riskut; përgjegjësitë për menaxhimin e riskut; si dhe rrugët që do ndiqen nga organet qeverisëse, menaxheriale dhe operacionale në nivel linje biznesi dhe në tërësi për zbatimin e kësaj strategjie. Duke marrë në konsideratë madhësinë e veprimtarisë së Shoqërisë, kompleksitetin e saj dhe profilin e riskut, strukturat përgjegjëse të krijuara për të ushtruar funksionin e administrimit të riskut janë Komiteti i Auditimit&Menaxhimit të Riskut, Njësia e Auditimit, Drejtoria e Menaxhimit të Riskut etj. Punonjësit e Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut, janë të trajnuar dhe zotërojnë kapacitetet e duhura profesionale për menaxhimin e riskut, sipas linjave të biznesit dhe në nivel Shoqërie. Ata kanë autoritet të plotë për marrjen e çdo informacioni të nevojshëm për ushtrimin e detyrave funksionale të përcaktuara në aktet rregullatore dhe aktet e brendshme të INSIG.

Drejtorja e Menaxhimit të Riskut, nëpërmjet Drejtorit të Përgjithshëm, komunikon me Këshillin Mbikëqyrës dhe Komitetin e Auditimit&Menaxhimit të Riskut në lidhje me vlerësimin e ekspozimeve ndaj riskut dhe masat që duhen marrë

për menaxhimin e tyre, vlerësimin e ndryshimit në profilin e riskut, vlerësimin e ngjarjeve të riskut, si dhe përcaktimin e veprimeve të përshtatshme për ndreqje të situatës.

INSIG aplikon metodologji dhe praktika bashkëkohore për identifikimin, klasifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e risqeve, në koherencë me kërkesat e AMF-së, të përcaktuara në Manualin e Mbikëqyrjes së Shoqërive të Sigurimit dhe akte të tjera rregullatore. Drejtoria për Menaxhimin e Riskut, në koordinim me strukturat qendrore dhe vendore, çdo vit identifikojnë risqet ndaj të cilëve është e ekspozuar veprimtaria e INSIG dhe që përbëjnë kërcënim për realizimin e objektivave strategjike dhe specifike të përcaktuara në Plan Biznesin vjetor. Risqet e identifikuara klasifikohen në shtatë kategoritë kryesore: Risku i Kreditit; Risku i Tregut, Risku i Sigurimit, Risku Operacional, Risku i Likuiditetit, Risku Ligjor&Rregullator dhe Risku Strategjik.

Bazuar dhe në vlerësime sasiore, në tërësi dhe sipas linjave të biznesit, në përfundim të procesit, bëhet një vlerësim cilësor i risqeve, duke i kategorizuar në nivelin: i ulët ose mesatar ose i lartë.

Procesi vjetor i Menaxhimit të Riskut në INSIG u finalizua me Raportin “Vetëvlerësimi i Riskut dhe Aftësisë Pagueuse për vitin 2021” (mars 2022). Për hartimin e këtij Raporti përdoren teknikat analitike: analiza PESTEL, analiza SWOT, analiza e linjave të biznesit, analiza e riskut, analiza e performancës së linjave të biznesit, analiza krahasuese e të dhënave etj. Raporti u është shpërndarë autoriteteve mbikëqyrëse, ekzekutive dhe menaxheriale. Gjithashtu, sipas përcaktimeve në aktet rregullatore, është hartuar dhe Raporti “Mbi Vlerësimin e Risqeve në INSIG për vitin 2021”, dërguar në AMF (maj 2022).

Në Raportin “Vetëvlerësimi i Riskut dhe Aftësisë Pagueuse për vitin 2021”, është pasqyruar një analizë e plotë e mjedisit të jashtëm dhe të brendshëm; një vështrim i përgjithshëm për menaxhimin e riskut në INSIG; janë identifikuar dhe vlerësuar risqet kryesore ndaj të cilëve është e ekspozuar Shoqëria, si dhe mënyra e kontrollit, raportimit dhe menaxhimit të këtyre risqeve. Për vitin 2021, nga analiza e të gjitha risqeve të identifikuar dhe vlerësuar, rezulton:

- Risku i Kreditit, Risku i Tregut (Risku i Normës së Interesit dhe Risku i Këmbimit të Monedhës së Huaj), Risku i Dizenjimit të Produktit dhe i Vendosjes së Çmimit (i trajtuar tek Risku i Sigurimit), Risku i Mashtrimit (i trajtuar tek Risku Operacional), Risku i Likuiditetit, Risku Ligjor&Rregullator, Risku Strategjik, Risku i Drejtimit të Brendshëm&Menaxhimit dhe Risku i Aftësisë Pagueuse klasifikohen në nivelin i ulët.
- Risku i Sigurimit (përkatësisht Risku i Marrjes në Sigurim dhe i Përgjegjësiave), Risku Operacional (përkatësisht Risku i Trajtitimit të Dëmeve dhe Risku i Teknologjisë së Informacionit) klasifikohen në nivelin mesatar.
- Tendencia e Raportit të Ndryshimit në Primet e Shkruara Bruto me Primet e Shkruara Neto në katër vitet e fundit është ruajtja e vlerave rreth mesit të

intervalit të vlerave të pranuar. Kjo tregon për një stabilitet të Shoqërisë INSIG, ku sistemet e saj të kontrollit dhe ato operacionale janë në gjendje të përballojnë volumin e një rritjeje konstante të biznesit.

- Është i rëndësishëm stabiliteti brenda normave të lejuara apo përmirësimi i vlerave të raporteve që tregojnë shëndetin financiar të Shoqërisë, ku veçojmë vlerën e Raportit të Kapitalit si Përqindje e Detyrimeve 77 pikë përqindje mbi pragun minimal të lejuar, Marzhin e Aftësisë Paguese 26 pikë përqindje mbi pragun minimal të lejuar, Raportin e Likuiditetit 70 pikë përqindje nën pragun maksimal të lejuar dhe Raportin e Sigurisë afro 2 pikë më pak se vlera maksimale e pranuar.
- Vlerësimi i Drejtimit të Brendshëm dhe Menaxhimit të Riskut në nivelin i fortë jep garanci për menaxhimin me efektivitet dhe zbutjen e risqeve ndaj të cilëve ekspozohet INSIG.
- Organet drejtuese dhe stafet e Shoqërisë, në tërësi dhe sipas linjave të biznesit, po ndjekin me prioritet problematikat e evidentuara specifikisht në analizën dhe vlerësimin e bërë për secilin risk kryesor, duke zbatuar masat dhe rekomandimet e dhëna.

OPINION I SHKURTUAR MBI AUDITIMIN E BRENDSHËM TË VITIT 2021 PËR SHOQËRINË "INSIG SHA"

Auditimi i brendshëm për vitin 2021 në shoqërinë e sigurimeve "Insig sha" është zhvilluar në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm dhe Manualin e Auditimit të Brendshëm, si dhe në zbatim të Ligjit nr. 52/2014, "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit", rregullores nr. 153, datë 23.12.2014, "Për veprimtarinë e Njesisë së Auditimit të Brendshëm dhe Komitetit të Auditimit në Shoqërinë e Sigurimit", rregullores nr. 2143/1, datë 22.12.2020, "Për organizimin dhe funksionimin e Shoqërisë Insig sha" dhe "Planit të Auditimit të Brendshëm për vitin 2021" të shoqërisë, miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 09, datë 22.12.2020.

Njësia e Auditimit të Brendshëm në vazhdimësi, gjatë gjithë vitit 2021, ka kontrolluar dhe audituar ecurinë e punës në fushat kryesore të veprimtarisë së Insig. Pas shqyrtimit dhe miratimit në Komitetin e Auditimit dhe Menaxhimit të Riskut, Raporti Vjetor i Auditimit të Brendshëm 2021, është miratuar dhe nga Këshilli Mbikëqyrës me vendim nr. 04, datë 12.05.2022. Raporti u është shpërndarë për njohje dhe zbatim të gjitha strukturave të Insig.

Departamenti i Marrjes në Sigurim. Gjatë vitit 2021 kompania ka pasur rritje të shitjeve në masën rreth 16%, krahasuar me vitin 2020 dhe rreth 9% krahasuar me vitin 2019. Në raport me kompanitë e tjera është një ndër kompanitë me rritjen më të madhe në treg. Raporti i sigurimeve të detyrueshme / vullnetare është 80 me 20%, kundrejt vitit të mëparshëm 83 me 17%, pra në vitin 2021 kompania ka pasur rritje të sigurimeve vullnetare.

Nëse i referohemi realizimit të objektivave sipas degëve rezulton se pothuajse të gjithë degët e kompanisë kanë tejkaluar objektivat e përcaktuara dhe janë me realizim mbi 100% të planit të shitjeve. Degët që kanë kontributin më të madh në realizimin e të ardhurave janë degët e Tiranës, Shkodër, Korçë dhe Durrës, ndërsa kontributin më të madh në realizimin e produkteve vullnetare e kanë degët Tirana 1 dhe Tirana 3.

Është rritur kontrolli i ushtruar nga strukturat e marrjes në sigurim në bashkëpunim dhe me Drejtorinë e Administrimit të Shitjeve dhe si rezultat i kësaj ka pasur përmirësim lidhur me zbatimin e procedurave të marrjes në sigurim. Të dhënat e shitjeve janë pasqyruar saktë në sistemin e brendshëm të kompanisë dhe janë kryer rakordimet përkatëse çdo muaj me strukturat e brendshme (Drejtoria e Administrimit të Shitjeve dhe Drejtoria e Financës), si dhe raportimi në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare është kryer konform udhëzimeve.

Drejtori të tjera të kompanisë. Gjatë vitit 2021 janë hartuar dhe miratuar një sërë rregulloresh dhe urdhërash me qëllim që të arrihet përputhshmëria e plotë me bazën ligjore, janë bërë përmirësime në Sistemin e Brendshëm në funksion të përshtatjes së tij me kërkesat e palëve të treta dhe strukturave të kompanisë,

si dhe ofrimit të një shërbimi më të mirë për klientët. Në sistemin e brendshëm të kompanisë janë të implementuar moduli i shitjeve, moduli i dëmeve dhe moduli financiar. Moduli i shitjeve është i integruar me modulën financiar dhe të dhënat e shitjeve transferohen automatikisht, si dhe është bërë i mundur raportimi online i dëmeve në AMF në kohë reale, nëpërmjet sistemit të brendshëm. Integrimi i moduleve në sistemin e brendshëm ka ndikuar në përmirësimin e procedurës së marrjes në sigurim, në uljen e riskut të mashtrimit dhe gabimit njerëzor, si rezultat i transferimit automatik të të dhënave nga një modul në tjetrin. Janë konstatuar problematika dhe mangësi të Sistemit të Brendshëm lidhur me mungesën e raporteve të nevojshme për strukturat, kufizimet për specifika të ndryshme të produkteve vullnetare etj., ndaj përmirësimi i sistemit të brendshëm, në funksion të lehtësimit dhe përmirësimit të punës është një nga objektivat kryesorë gjatë vitit 2022.

Drejtoria e Dëmeve funksionon mbi bazën e rregulloreve, udhëzimeve, urdhërave të brendshëm të kompanisë. Gjatë vitit 2021 është arritur që, sipas udhëzimeve nga Drejtoria e Përgjithshme, të trajtohen e të dëmshpërblehen klientët brenda afateve të përcaktuara. Janë trajtuar me prioritet rastet e klientëve, të cilët nuk kanë qënë dakort me dëmshpërblimet, të cilat janë diskutuar në komisionet e posaçme me qëllim që t'u shërbehet sa më mirë klientëve dhe të kryhet vlerësim sa më i drejtë. Përgjithësisht praktikat janë plotësuar me dokumentacionin e nevojshëm dhe gjatë trajtimit rezulton se janë zbatuar kushtet e kontratave të sigurimit.

Drejtoria Juridike është angazhuar në ndjekjen e proceseve gjyqësore të kompanisë Insig, si dhe ndjekjen e proceseve gjyqësore të rasteve të Fondit të Kompensimit për llogari të BSHS. Nga ana e juristëve janë ndjekur të gjithë proceset gjyqësore të kompanisë dhe përgjithësisht janë angazhuar dhe ekspertë të fushave përkatëse (mjek, vlerësuesi i dëmeve etj.) me qëllim mbrojtjen sa më të mirë të interesave të kompanisë. Përgjithësisht rezultatet e gjyqeve kanë qënë në favor të kompanisë, gjë që tregon punën e kujdesshme të bërë dhe nga punonjësit e dëmeve.

Statistika. Të dhënat lidhur me shitjet, anulimet, kthimet, dëmtimet e policave janë të pasqyruara saktë në sistemin e brendshëm të kompanisë dhe janë raportuar saktë në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare. Të dhënat lidhur me praktikën e dëmeve janë pasqyruar saktë në databazën e dëmeve, si dhe janë raportuar saktë në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare. Janë respektuar afatet e dërgimit të evidencave ndërmjet strukturave, si dhe afatet e dërgimit në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare.

Mbrojtja nga Risku. Shoqëria Insig sha gjatë vitit 2021 ka hartuar "Strategjinë për Menaxhimin e Riskut", në të cilën janë përcaktuar sistemi, politika dhe parimet e menaxhimit të riskut. Në këtë strategji është përcaktuar në mënyrë

të plotë procesi i menaxhimit të riskut, përgjegjësitë dhe detyrat e strukturave të kompanisë për identifikimin dhe menaxhimin e risqeve.

Manaxhimi i Riskut ka hartuar “Raportin e Vetëvlerësimit të Riskut dhe Aftësisë Paguese”, në të cilin janë identifikuar dhe vlerësuar nivelet e risqeve, ndaj të cilave është e ekspozuar shoqëria, si dhe janë dhënë rekomandimet e nevojshme për menaxhimin e tyre, me qëllim reduktimin e risqeve të identifikuara, si dhe parandalimin e ekspozimit ndaj risqeve në të ardhmen.

Në përgjithësi ka funksionuar sistemi i kontrollit të brendshëm brenda departamenteve dhe njësive të audituara, si në drejtim të hartimit të procedurave, menaxhimit të shpenzimeve dhe administrimit të dokumentacionit. Janë kryer investigime, verifikime, vlerësime dhe kontrole paraprake të dokumentacionit justifikues. Ky sistem me procedurat dhe verifikimet përkatëse ka ndikuar në identifikimin, kontrollin dhe administrimin e risqeve që mbulojnë dhe menaxhojnë departamentet dhe njësitë e audituara.



Emin Duraku Str. Binjaket Build.
No.5, 1009, Tirana
Albania
Tel: +355 4 2222 889
www.mazars.al

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Drejtuar : Menaxhimit dhe Aksionerëve të shoqërisë INSIG SHA

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë Insig sh.a (Shoqëria) të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 dhjetor 2021, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin që mbyllet në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

